



Nr. 12.060/04 24906 dt. 09.07.2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 22.06.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtoret e drejtorive përkatëse.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.05.2020.
2. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli”.
3. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF „Drenasi”.
4. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV „Feronikeli”.
5. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH „Drenica”.(M).
6. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF „Feronikeli”.
7. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA „Shote Galica”.
8. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ „Shqipet e Drenicës”.
9. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimt Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .
10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
11. Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028.
12. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.
13. Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.
14. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërm.
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj :hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës dhe i njoftoi për pikën e katërmbëdhjetë (14), se ka një ndryshim të përcaktimit të emrit të kjo pikë por jo të përmbajtjes së tekstit.

Pasi nuk pati diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hodhi në votim rendin e ditës , prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.05.2020.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli”.

Fjalën ja kaloi drejtoreshës për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu – përshëndeti të gjithë të pranishmit edhe këtë vit sikurse edhe vitin e kaluar, ndarja e subvencioneve ve ka ardh si rezultat i punës së komisionit vlersues gjithçka është bazuar në rregulloren Nr. 04.2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe rregullores Nr. 320.1932 mbi kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, arsyeja pse sot jam KPF-ca dhe do të shkoj në kuvend është vetëm respektimi i vendimit me Nr. 400-37743. dt 03.07.2018. I cili vendim ja cakton kryetarit një kufi deri në limitin 1500 € dhe duhet ta merr edhe aprovimin e asmbles për me i ndarë këto subvencione .

Këtë vit janë shpallur 79.000€ subvencione të caktuara paraprakisht Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport :në sektorin e Rinis janë specifikuar 3000€, në sektorin e Kulturës 11.000€ në sektorin e sportit 65.000€ për dallim nga vite e kaluara kemi rritje për dy sektor,vitin e kaluar ka qenë 4500për sektorin e kulturës sivjet kemi 11.000€ ndërsa janë ndarë me anë të thirrjes 8.900 ndërsa ne kemi të drejt jashtë thirrjes edhe një përqindje ,5% na lejon rregullorja për ndonjë aktivitet relevant nëse na lejojnë rrethanat pasi është kohe pandemie edhe ne sektorin e Sportit ka pasur rritje nga 50.000€ si vjet i kemi 65.000€ kurse ai i rinis ka mbetur i njëjtë 3000€.

Burim Bujupi –Faleminderit kryesues në krahasim me vitet e kaluara në këtë vit keni bërë shpërndarjen e subvencioneve me mirë sepse janë përfshi tre sektorët pak me shumë kishte qenë mirë ne letër me pas shumën totale të subvencioneve, kam një pyetje pse nuk po e sjellin cilat janë kriteret kur po behët ndarja e subvencioneve dhe kush janë anëtarët e komisionit dhe nëse ka mundësi herav tjera ne komision me qen edhe një anëtar prej kuvendit për me dit se si po shkojnë procedurat dhe rrjedhja e e ndarjeve të subvencioneve .

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu –në bazë të rregullores nuk lejohet me pas anëtar nga Kuvendi rregullorja e specifikon që anëtarët e komisionit të jen një prej shoqërisë civile një që cilësohet si ekspert i fushës edhe tre anëtarët e tjerë të jenë nga niveli ku jepet subvencioni në këtë rast një përfaqësues prej DKRS një prej zyrës së financave dhe një

përfaqësues tjetër ,sa i përket ndarjes totale të subvencioneve vendimi është i publikuar në ueb faqe të komunës i cili ka Nr. 10.40018099. dt. 04.06.2020 në të cilin specifikohen saktë tri sektorët të cilët subvencionohen po ashtu specifikohet emri i projektit për cilin shkon mbështetja financiare vlere e mbështetjes dhe përfituesi i OJQ-ve dhe është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit në të cilin mund ta dini se kush kanë qenë anëtarët e komisionit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci—Burim nuk e pengon askënd me marrë pjesë si asambleista me i përcjell punimet e komisionet por nuk kanë drejt me ndërhy por vetëm më vëzhgua, kur të vjen në kuvend nëse nuk u bërë mirë atëherë e ngritni zërin dhe kërkon mos me u votu.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu-edhe një çështje mbi kriteret në fakt thirrja publike ka qenë e publikuar në ueb faqe të komunës po i llogaritur ditët e pushimit ka zgjat diku një muaj bashkë me thirrjen publike kanë qenë edhe udhëzimet se si duhet të aplikoni dhe cilat kriteret duhet të plotësohen dhe të gjithë formularët,dhe vlen të theksohet se në këtë vit të gjithë ata që kanë aplikuar për subvencione janë subvencionuar si dhe për pesë ditë që ka pas afat ankese nuk e kemi pas asnjë ankese.

Burim Bujupi - por e thash edhe me herët që sivjet është bërë një punë me e mirë mendoi që ka ka qenë me mirë me pas edhe ne si material me ditë sa ka qenë vlere e subvencioneve , shumë e thjesht dy tri letra me shumë,mendoi që herëve tjera përveç anëtareve të kuvendit me qenë edhe përfaqësues të klubeve dhe të artit për shkak se janë te thirrur me shumë për këtë punë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-anëtarët e komisionit janë të publikun edhe në ueb faqe të komunës në intranet dhe çdo vendim që e marrim që protokollohet që hyne në intranet është publik unë të falënderoi që po thoni që si vjet është më mirë se vitet e kaluara.

Kryesuesi i Kuvendit - hodhi në votim pikën e parë të rendit e ditës prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e tretë e rendit të ditës: 3. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF„Drenasi”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e katër e rendit të ditës: 4. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KV„Feronikeli”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e pestë e rendit të ditës: 5. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KH,,Drenica”.(M).

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e gjashtë e rendit të ditës: 6. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për KF,,Feronikeli”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e shtatë e rendit të ditës: 7. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për SHKA,,Shote Galica”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e tetë e rendit të ditës: 8. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për OJQ,,Shqipet e Drenicës”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim të pika e nëntë e rendit të ditës: 9. Propozim Vendim për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimt Rinor Lokal (KVRL)-Drenas .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dhjetë e rendit të ditës: 10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.

Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër Ruzhdi Lestrani- përshëndetje për të gjithë.

Duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:

Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me ato prona:

Kontrata e lidhur me datë 13/05/2010, me nr.465-1036, me sipërfaqe 0.10.00 ha, e cila është pjesë e ngastrës nr. 1/8, në Zonën Kadastrale në Komoran.

Shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë N.SH “EURO-B-LAB” me Sala Shala-Gjoshi nga fshati Sankoc.

Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhdimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale.

Sa për informacionin tuaj, në lidhje me këtë çështje i kemi shkruar edhe Ministrinë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku i kemi kërkuar sqarime se si të veprojmë, e njëjta është përgjigjur se të gjitha pronat e dhëna në shfrytëzim pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratë i kthehen komunës.

Andaj, prona e lartcekura, edhe në bazë të listës së veçantë, ashtu siç e parasheh neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nuk është paraparë që të epet në shfrytëzim për këtë vit, po ashtu kjo parcelë do të vlerësohet nga ana e Komunës së Drenasit, se e njëjta a do të jepet në shfrytëzim apo do të shfrytëzohet për interesat e Komunës së Drenasit, gjithnjë në përputhje me planin zhvillimor ekonomik të Komunës sonë.

Bashkangjitur gjeni kërkesën nga Komuna e Drenasit, si dhe përgjigjen e MAPL-së Nr .463-32, të datës 10.01.2020.

Burim Bujupi - faleminderit drejtor për sqarimin kishte qenë mirë me pas material shtesë me ditë që pronari që ka pas këtë parcelë në shfrytëzim ai është përmbajtur kontratës deri me tani dhe në qoftë se edhe në të ardhmen i jepet prapë .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-është komisioni që del dhe i sheh çdo gjashtë muaj të gjitha kontratat e dhëna në shfrytëzim dhe a janë duke e zbatuar kontratën të cilën e ka lidh me komunën ,çfarë do që kërkon jemi të obliguar me ia sigurua në vitin e fundit nuk ka zhvillu veprimtari ky subjekt afarist ky subjekt ka pas probleme me vendosen e objektit në pronën e komunës sepse i ka marr 10 ari ne shfrytëzim ndërsa i ka shfrytëzua 20-30 ari pasi e ka shpall komuna uzurpator ky subjekt e ka lirua pronën të cilën e ka shfrytëzua pastaj e ka dërgua lëndën në gjykatë për me kërkuar me ia vazhdua kontratën edhe për 40 ose 99 vite dhe komuna nuk e sheh të arsyeshme me negociua për shkak se lexoi me herët drejtori arsyetimin ,me ligj si

komunë e kemi obligim me lajmërua seancën dhe me njoftua se i ka skadua afati kësaj prone dhe prona është në emër të komunës është pronë e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, ka dikush diçka, rreth njoftimit për e rekomandoim për kuvend si njoftim.

Kalojmë te pika e njëmbëdhjetë: 11. Propozim Vendim për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: fjalën ia kaloj Drejtoreshës Flutra Avdiu.

Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Procesi i hartimit të PZHK-së ka filluar me vendimin për hartimin e PZHK-së marrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Glllogocit (Drenasit). Ekipi Komunal i Planifikimit ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e PZHK-së në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë. Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Glllogocit (Drenasit). Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së PZHK-së në faza të ndryshme të hartimit. Procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjell me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe me mbajtjen e punëtorive për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028. Për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028, bazuar dhe në nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4 paragrafi 3 pika 3.1, neni 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12, është miratuar vendimi për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028. Pas miratimit të vendimit për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028, Komuna e Glllogocit ka shpallur njoftimin publik në të cilën janë njoftuar qytetarët se do të bëhet hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimin publik të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Me datë 05 shkurt 2020, Komuna e Glllogocit ka hapur Shqyrtimin Publik për Projekt Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, shqyrtimi publik ka zgjatur 30 ditë nga dita e hapjes, në mënyrë që të kontribuohet në dhënien e vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike: pzhkdrenas@gmail.com, po ashtu duke pasur dhe mundësinë për qasje në versionin digjital të dokumentit të PZHK-së në vegzen elektronike <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.

Pas përfundimit të afatit ligjor për shqyrtim publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, Ekipi Komunal për Planifikim (EKP), Ekipi Këshillues i Komunitetit (EKK), ekspertet e kompanisë hartuese të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit, ekspertet e GIZ-it gjerman, kanë analizuar të gjitha kërkesat vërejtjet, sugjerimet nga ana e qytetarëve dhe në bazë të arsyeshmërisë dhe mbështetjes ligjore janë inkorporuar në Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028. Pas inkorporimit të komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me vlerësimin profesional nga ana e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, është dorëzuar Kërkesa për miratimin përfundimtar të Projekt- Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në të cilën është marr Vendim për dhënien e Pëlqimit për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.

Falënderim i veçantë për kontribuuesit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, Ekipin Komunal për Planifikim, Ekipin Këshillues të Komunitetit, ekspertet e kompanisë hartuese të PZHK-së, ekspertet e GIZ-it gjerman, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, duke i'u ftuar të gjithëve në miratimin e këtij dokumenti të planifikimit hapësinor, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12 Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.**

Fjalën ja kaloi drejtorit për Financa Shyqyri Bublaku- përshëndetje për të gjithë sa i përket Draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023 kësaj i paraprin qarkorja buxhetore. Kjo Qarkore do të jetë e para në serinë e qarkoreve që do të sigurojnë informata për komunat lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal.

Çdo individ apo familje, i planifikon shpenzimet në bazë të mjeteve që ka në dispozicion, apo një familje e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti-të hyrat që ka dhe të cilat mund t'i shpenzojë për gjërat elementare sikur se janë të ushqyerit, veshmbathja, pagesa për qira, shpenzime komunale, argëtimi, rekreacioni, etj. Në të njëjtën mënyrë edhe komuna i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton dhe ka në dispozicion. Ajo planifikon se sa nga të hyrat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të komunës si për shembull, për pagat e të punësuarve në sektorin publik, për shpenzime operative dhe shpenzime kapitale. Ndryshe nga buxheti i individit-familjes, buxheti i komunës planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet

„viti buxhetor”. Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore në të ardhmen.

Buxheti i komunës mbushet nga Grantet e Qeverisë (granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi); të Hyrat nga Burimet Vetanake (tatimi në pronë, taksa dhe ngarkesa, të hyra nga pasuria, gjobat nga trafiku dhe gjykatat, etj.) dhe të Hyrat nga palët e treta. Indikatorët që përdoren për alokimin e **Grantit të Përgjithshëm** në komunë janë:

-Numri i popullsisë llogaritet (89%);

-Përmasat gjeografike të komunës (6%);

-Numri i popullsisë pakicë në komunë (3%);

-Komunat ku shumica e popullsisë së të cilëve përbëhet nga pakicat kombëtare (2%)

Granti Specifik për Arsim, trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë parasysh këto elemente:

-Numri i nxënësve të regjistruar për vitin shkollor përkatës;

-Raporti nxënës mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm.

Granti Specifik për Shëndetësi, kriteret e aplikuara për ndarje të grantit specifik të shëndetësisë janë:

-Vizita për kokë banori;

-Shërbime për kokë banori;

-Kosto mesatare për vizitë.

Projeksionet e THV-ve (të hyrat vetanake) për vitet 2021-2023, bazohen në të hyrat e arkëtuara gjatë viteve paraprake dhe ato të arkëtuara në pjesën e parë të vitit aktual.

Komuna duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 të Qeverisë së vendit, Qarkoren Buxhetore 2021/01-M.F, Qarkoren Buxhetore Interne 2021/01 dhe analizat e

të Hyrave nga Burimet Vetanake, planifikon këtë kornizë buxhetore sipas viteve dhe sektorëve kryesor:

Tabela 1. Buxheti total i komunës sipas sektorve dhe viteve, shprehur në euro.

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali 2020	Projeksioni 2021	Projeksioni provues	
			2022	2023
Spektori i Përgjithshem	7,351,549	7,169,887	7,539,731	7,962,939
Spektori i Arsimit	7,152,418	6,472,573	7,039,890	7,070,544
Spektori i Shëndetësisë	1,986,376	2,084,614	2,939,945	2,956,474
Gjithsej:	16,490,343	15,727,074	17,519,566	17,989,957

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,

prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: 13Propozim Vendim për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: fjalën e kaloj Drejtoreshës Flutra Avdiu- Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunësduke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunalë, ka bërë Rekomandimin Nr.01-462-20469, të datës 16.06.2020 për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastra.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës 12-Nr. 400-23049 të datës 02.05.2019, është formuar Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në përbërje prej pesë anëtareve.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2020, anëtarët e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, bazuar në Listën 01-Nr.030--73863 të ngastrave kadastrale sipas zonave kadastrale në pronësi të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për këtë vit të publikuar me datë 30.12.2019, pas diskutimeve, anëtarët e komisionit shqyrtuan, dhe vendosen të propozojmë disa parcela kadastrale të bashkohen e disa të ndahen, me qëllim të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik

në komunë, dhe për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme, propozuan ndarje dhe bashkim të parcelave kadastrale si në vijim:

1. Parcela kadastrale Nr.202-0 zona kadastrale Komoran, propozohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale me sipërfaqe $S=0.37.00$ ha.

Ndarja e kësaj parcele propozohet të bëhet me qëllim që shtrati i Lumit të ndahet nga parcela 202-0 dhe shtrati i lumit të këtë parcelën e ndarë sipas komesacionit.

2. Parcela kadastrale 1-5, 1-6, 1-7, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale me pjesën e parcelës1,dhe ndarja e një parcele të re në zonën kadastrale Komoran me sipërfaqe $S=1.12.79$ ha.

3. Parcela kadastrale 4-100 zona kadastrale Komoran, propozohet bashkimi i parcelës me sipërfaqe $S=0.02.00$ ha dhe ndarja e parcelës kadastrale në mënyrë që të këtë qasje në rrugë publike, dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe $S=0.32.66$ ha.

4. Parcela kadastrale 4-85, 4-86, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale zona kadastrale Komoran, me sipërfaqe $S=0.20.00$ ha, me qëllim të krijohen kushte me të përshtatshme për investitorët dhe të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik të parcelës kadastrale.

5. Parcelat kadastrale 704-0, 705-0, 706-0, 707-0, 708-1, 708-2, 709-0, 710-0 dhe 711-0, propozohet ndarje dhe bashkim i parcelave kadastrale.

Ndarja e parcelës kadastrale 708-0, 709-0 dhe 710-0 për arsye se në një pjesë të këtyre parcelave është realizuar projekti i Ndërtimit të shtratit të lumit Vërboc. Pas ndarjes së parcelave kadastrale të lartë cekura të bëhet bashkimi i parcelave 704-0, 705-0, 706-0, 707-0 dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe të përafërt $S=1.86.00$ ha zona kadastrale Gllogoc.

6. Parcela kadastrale 503-1, 503-2 dhe 502-0, propozohet bashkimi i parcelës zona kadastrale Gllobar, dhe krijimi i një parcele të re me sipërfaqe të përafërt $S=0.68.63$ ha me qëllim të krijohen kushte me të përshtatshme për investitorët dhe të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik të parcelës kadastrale.

7. Parcela kadastrale 150-1, 150-3, zona kadastrale Arllat, propozohet të bëhet bashkimi dhe ndarja e parcelës me sipërfaqe $S=0.43.58$ ha për arsye se në këtë parcelë është e ndërtuar autostrada M9.

Bashkimi dhe ndarja e parcelave kadastrale, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunalë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcaktohet se për Rregullimin e pronës nga

komuna dhe duhet ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, duke marr vendim Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur gjeni Rekomandimin Nr.01-462-20469, të datës 16.06.2020, të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. Skicat e parcelave të propozuara për bashkim dhe ndarje.

Fletët poseduese të parcelave të cekura me lartë.

Burim Bujupi-në qoftese ka mundësi pak me qartë të parcela kadastrale 150.1, 150.3 pika nr 7 është zonë kadastrale në Arllat propozohet të bëhet bashkimi dhe ndarja e parcelës prej 0.43 çfarë interesi të përgjithshëm ka komuna në këtë rast, dhe a po kërkohet bashkimi edhe i kësaj pjesës së autostradës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-komuna nuk i ka kontrolluar pronat e veta ,sa i përket Arllatit kemi bërë zgjidhje që prona jonë mos me humbe,sepse dikush e ka pas me qira 10 ari tani mundet me i pas 30 ose 40 ari në shfrytëzim sepse e kemi bërë bashkimin e pronave, dhe i kemi dhënë qasje të gjithë qytetareve në rrugë një pjesë mbetet në anën e kundërt nuk është në këtë parcelë jo autostrada në anën tjetër që e lidh Negrocin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 5 anëtar , Kundër nuk pati, Abstenim 2.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërmbëdhjetë të rendit të ditës: **14.** Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel të Epërm.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: fjalën e kaloj Drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër Ruzhdi Lestrani -Duke pasur parasysh nevojat e mëdha dhe kërkesat për krijimin e kushteve sa me të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive për të rinjtë - qytetarët e Komunës se Drenasit. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport me kërkesën nr.10-400/01-20464 të dt. 16.06.2020 i është drejtuar Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për inqizimin e dy lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive në dy zona kadastrale.

Drejtorati për Gjeodezi. Kad. dhe Pronë me datë 16.06.2020 ka caktuar ekipin profesional i cili në bashkëpunim me përfaqësuesit të Drejtoratit për Kulturë,Rini dhe Sport, kanë përcaktuar dhe kan berë matjet gjeodezike për të dy lokacionet për fushat sportive në dy zona kadastrale dhe ate në Zabel i Epërme dhe në Abri e Epërme .

Pjesë përbërëse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Çertifikatat mbi të drejtat e pronës dhe kopjet e planit për ku do bëhet ndërtimi i dy fushave sportive për qytetarët e Komunës se Drenasit.

Burim Bujupi- nëse ka mundësi me ditë më qenëse po jepen këto dy parcela a është mëndu nga me ardh donacioni për ndërtimin e këtyre fushave nga cilat mjete,apo mos është fusha ndihmese që ka me ju jep Feronikelit.

Drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër Ruzhdi Lestrani-planifikimi për këto dy fusha është bërë në vitin e kaluar është buxheti janë planifikimet me të hyrat tona janë 83.600€ bashkë me grande.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Shqipe Zogu-lokacionet e caktume kanë ardh si kërkesa të banorëve të fshatit dhe prioritet i kemi jep këtyre dy lokacioneve për shkak se në Zabel të Epërm siç e dini nuk ka shkolla as asnjë teren sportiv, ndërsa në Abri të Epërme për shkak te territorit thell gjeografik dhe ofrimit të mundësive dhe kushteve me të mira të rinjtë të Abris, por nuk do te thotë që nuk kemi pas edhe kërkesa të tjera ,për me i realizua edhe kërkesat e tjera edhe në kornizën afat mesme i kemi planifiku 115€ për ndërtimin e terreneve sportive,në kuadër të vlerës 83.600 këtë do të filloj edhe ndërtimi i këtyre dy fushave se a mbaron a jo nuk e di, është edhe drenazhimi i tri fushave Polluzh ,Komoran dhe Damanek.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-kemi pasur edhe shumë kërkesa tjera si ne Gllobar , Korrotic, Dobroshec ,të gjitha fshatrave e kanë të lejuar që ti përdorin terrenet sportive të shkollave pas orarit të mësimi,ndërsa fusha sintetike pritet me fillu shumë shpejt,gjithashtu edhe ndërtimi i QKMF-së,si dhe pishinën gjysmë olimpike ne Komoran.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar: *Për votuan 7 anëtar ,Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.*


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: 15. **Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 10 min.

Drenas 22.06.2020

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimçaku Subashi




Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj